



DATE: 02.10.2023

NR.09/ 8281 /2023

## KONTRATË PËR SHITJE TË ASETEVE

Numri i kontratës <sup>1</sup>:KKHE 002/23

KOMUNA HANI I ELEZIT, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues-Shitësi i aseteve"), në njërën anë; dhe  
ANUAR SH.P.K.-Prishtinë, (në vazhdim "Blerësi"), me NUI.810854085 në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për shitje të aseteve shënuara me poshtë:

**Shitja e Aseteve (Shitja e aseteve - Autobus defekt)** me numër identifikues: Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë shitja e aseteve si në vijim:

Nr.	Grupi
1	Shitja e Aseteve (Shitja e aseteve - Autobus defekt)

**Neni 2 Kushtet e dërgesës**

2.1 Afati kohor për dorëzim do të jetë ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i dorëzimit të shitjes do të jetë Komuna Hani i Elezit ..në vendin ku gjenden asetet e shitura.

2.3 Inkotermi<sup>2</sup> i zbatueshëm do të jetë .

**Neni 3 Origjina**

3.1 Furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës.

3.2 Origjina e mallrave do të përcaktohet sipas Kodit të Doganave të Bashkësisë Evropiane (Community Customs Code-) ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar vendi në fjalë.

**Neni 4 Çmimi**

4.1 Çmimi total i shitjes është: **1,777.00 (Shitja e aseteve - Autobus defekt) €**; [Njëmijë e shtatëqindë e shtatëdhjetë e shtatë Euro/00 centi] Euro.

4.2 Çmimi i përmendur në Nenin 4.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që blers i theksuar me lartë i ka borgj Autoriteti Kontraktues (Komuna Hani i Elezit) sipas kesaj kontratës.

4.3 Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

[Çmimi i shitjes është i prerë dhe nuk i nënshtrohet ndryshimeve gjatë kohëzgjatjes së kontratës]

Çmimet e artikujve që janë subjekt të rregullimit të çmimit janë subjekt i rregullimeve në vijim: *N/A*

4.4 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

<sup>1</sup> Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

<sup>2</sup> Incoterms 2010 Oda Ekonomike Nderkombëtare

## Neni 5 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kjo marrëveshje e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare;

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

## Neni 6 Komunikimet

6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

6.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

6.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën Shqipe<sup>3</sup> në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Furnizuesin.

### Për Autoritetin Kontraktues-Shitesi i aseteve

Emri:	Xhevdet BUSHI
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	02.10.2023
Vula:	

### Për Blerësin e aseteve

Emri:	Nazif Krasniqi
Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:	
Data:	02.10.2023
Vula:	

<sup>3</sup> Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.



## KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës:

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

*[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]*

<b>Kushtet e Përgjithshme të Kontratës</b>		<b>Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK</b>
<b>Përshkrimi i nenit</b>	<b>Nr. Nenit</b>	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbuloohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	1.2	Gjuha e përdorur do të jetë Shqipe.
Siguria e ekzekutimit	2	Sigurimi i ekzekutimit të kontratës në 10% e vlerës së kontratës me afat prej 60 diteve apo 2 muaj
Sigurimi	2.1	Sigurimi i ekzekutimit të kontratës në 10% e vlerës së kontratës me afat prej 60 diteve apo 2 muaj
Programi i ekzekutimit	3.	<i>[Kohë-gjatja e kontratës është me afat prej 30 ditë nga koha e nënshkrimit të saj]</i>
Cilësia e Aseteve	6.	<i>Asetete janë të përdorura dhe shiten ashtu ku janë si janë dhe AK-nuk mban përgjegjësin për me tej pas dorëzimit të tyre</i>
Inspektimi dhe testimi i aseteve	7.	<i>Asetet shitjen në at gjendje si janë dhe ka qene koha kur OE-apo personat fizik kanë pasur afatin e tyre për të parë asetet që po shiten.</i>
Pagesa e aseteve që shiten	8.	<i>Pagesa do të bëhet brenda afati të kohë-gjatje së kontratës, dhe mjetet do të dalin në llogari të AK-së Komuna Hani i Elezit</i>
Dorëzimi i aseteve	9.	<i>Dorëzimi do të bëhet pas pas realizimit të pagesës nga blërsi i aseteve i deshmuar me konfirmim të realizimit të pagesës në bankë</i>  <i>Terheqja e aseteve nga vendi ku gjenden duhet të bëhet sa më shpejt nga ana e blërsit, pas realizimit të pagesës dhe dorëzimit të deshmis së pagesa është realizuar për shitjen e asetit të AK- Komuna Hani i Elezit</i>
Obligimet e garancionit	10	<i>N/A përveq Sigurimi i ekzekutimit të kontratës në 10% e vlerës së kontratës me afat prej 60 diteve apo 2 muaj</i>
	10.1	<i>Shitja e aseteve bëhet sipas parimit ku janë si janë dhe AK-nuk mban përgjegjësi me tej pas dorëzimit të tyre tek blërsit.</i>
Shërbimet pas shitjes	11.	<i>AK-nuk mban përgjegjësi për me tej pas dorëzimit të aseteve blërsit</i>
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	12.	<i>Zyra e Prokurimit – Komuna e Hanit të Elezit ose përmes procedurave alternative të zgjidhje së mosmarrëveshjeve-procedurat e ndërmjetesimit me pajtimin e të dy palëve</i>
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	13.	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet <i>[Gjykata Komerciale në Prishtinë]</i> në pajtim me ligjin në Kosovë.  b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të <i>[specifiko organin për zgjedhjen e mosmarrëveshjes]</i> në pajtim me <i>[specifiko rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Komisioni i Komëve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht)].</i>